

URDHËR
Nr. 95, datë 27.11.2024

PËR DELEGIM TË KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr. 61/2023, “Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së *cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale”; të nenit 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Kontrollit të *Cannabis*-it, të z. Arlind Lugji, me funksion Koordinator në Sektorin e Autorizimeve, Lejeve dhe Licencave në Drejtorinë e Standardeve, Autorizimeve, Lejeve dhe Licencimit në Agjencinë Kombëtare të Kontrollit të *Cannabis*-it për periudhën nga data 2.12.2024–6.12.2024.

2. Për vendimmarrje të një rëndësie të veçantë apo çështje të caktuara, z. Arlind Lugji duhet të marrë miratim paraprak nga drejtori i përgjithshëm nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri z. Arlind Lugji dhe punonjësit e Agjencisë Kombëtare të Kontrollit të *Cannabis*-it.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Linda Pustina